

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-09-0107

Në padinë e

[REDACTED]

[REDACTED], Kragujevc, Republika e Serbisë

Paditësja/Ankuesja

Kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr. 8
10 000 Prishtinë

E Paditura

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 24 nëntor 2009, SCEL-09-022 C-15, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Refuzohet ankesa si e pabazuar.**
- 2. Miratohet Aktvendimi i Trupit Gjykses në lëndën SCEL-09-0022 C-15, date 24 nëntor 2009.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më 28 tetor 2009 Paditësja ushtroi një ankesë duke kërkuar që DHPGJS-ja ta përfshijë atë në listën përfundimtare si punëtore me të drejta legjitime të NSH

II

"██████████" në Ferizaj. Paditësja ka pohuar se ajo ka qenë punëtore e NSH-së nga 1 shkurti 1992 deri më 18 korriku 1998.

Në aktvendimin SCEL-09-022 C-15 të datës 24 nëntor 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së e refuzoi ankesën si të papranueshme, pasi që ankesa është parashtruar jashtë afatit kohor, të përshkruar sipas Nenit 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Periudha kohore për parashtrim të ankesave kundër listës ka përfunduar më 1 gusht 2009.

Më 23 dhjetor 2009 Paditësja (më tej Ankuesja) ka ushtruar një ankesë kundër aktvendimit të sipërpërmendur. Në ankesën e saj ajo pohon se që nga 25 qershori 2009 deri më 8 tetor 2009 ajo ka qenë nën trajtime mjekësore në spital, prandaj ajo nuk ka pasur mundësi që parashtrorë ankesën e saj brenda afatit kohor. Si mbështetje për këtë, Ankuesja ka ushtruar një fletë lëshim nga spitali me anë të së cilës verifikohet hospitalizimi i saj për periudhën që ajo ka përmendur.

Më 2 shkurt 2010 Kolegji i Ankesave lëshoi një urdhër duke kërkuar nga Ankuesja që të parashtrorë brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të urdhrit një kopje të aktvendimit të ankimuar duke përcaktuar datën në të cilën aktvendimi i është dorëzuar asaj, si dhe arsyet përse fletë lëshimi nga spitali nuk është prezantuar në kohën kur ajo ka ushtruar ankesë më 28 tetor 2009 pranë DHPGJS-së.

Më 17 shkurt 2010 Ankuesja është përgjigjur në urdhër duke parashtruar një kopje të aktvendimit të apeluar dhe duke përsëritur se ajo nuk ka qenë në gjendje që të ushtrorë një ankesë pasi që ajo ka qenë nën trajtim. Sa i përket arsyeve për mos-parashtrim të letrës në kohën e ushtrimit të ankesës, ajo ka pohuar se një gjë të tillë e ka bërë për shkak të injorimit të procedurës, dhe se ka menduar që të dorëzorë vetëm ato dokumente që do të dëshmonin kualifikimin e saj si punëtore e NSH-së së sipërpërmendur.

Më 3 mars 2010 ankesa dhe dokumentet mbështetëse i janë dorëzuar të Paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Në mbrojtjen e saj AKP-ja i ka kërkuar DHPGJS-së që të refuzorë ankesën si të "pabazuar" pasi që Ankuesja

kishte parashtruar një kopje të pavërtetuar të fletë lëshimit nga spitali, e cila nuk mund të pranohet si dëshmi ligjore. Për më tepër, kërkesa e Apeluesit që të kthehet në gjendjen e mëparshme nuk qëndron pasi që sipas mendimit të AKP-së ajo ka mundur që të autorizojë një avokat për ta përfaqësuar atë si dhe të dorëzojë dokumentet brenda afatit kohor. Prandaj, aktvendimi i Trupit Gjykses duhet të miratohet.

Më 14 prill 2010 mbrojtja e AKP-së i është dorëzuar Ankueses, në pajtim me Nenin 62 të Urdhërësës Administrative 2008/6, me një këshillë në lidhje me Nenet 62.1 dhe 62.3 të së njëjtës UA, në lidhje me mundësinë që Ankuesja të ushtrojë më tutje një reagim. Pas kësaj nuk është parashtruar më asnjë shkresë.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar.

Ankesa në esencë trajton arsyet që duhet të merren në konsideratë për një kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme: Ankuesja kërkon që ankesa e saj të konsiderohet nën dritën e faktit që ajo nuk ka pasur mundësi të parashtronte ankesë në kohë për shkak se ka qenë e hospitalizuar nga 25 qershori 2009 deri më 8 tetor 2009, një periudhë kohore gjatë së cilës afati kohor për parashtrimin e ankesave kundër listës kishte skaduar.

Neni 10.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 thotë se: "Pas paraqitjes së kërkesës nga individë apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garanci mbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13. (a) Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime (...)"

Ankesa e Ankueses është ushtruar pranë Trupit Gjykses më 28 tetor 2009, shumë larg nga afati kohor për parashtrim të ankesave e cila kishte skaduar më

IV

1 gusht 2009. Prandaj, Trupit Gjykses në mënyrë të saktë e refuzoi ankesën si të papranueshme.

Neni 118 paragrafi 4 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (më tek LPK, Gazata Zyrtare e RSFJ 4/77 – 1478, 36/80 – 1182; 69/82 – 1596), i aplikueshëm në bazë të Nenit 70, paragrafi 3 (a) të UA të UNMIK-ut 2008/6, specifikon se, nëse një palë nuk arrin të ndërmarrë ndonjë veprim në procedurat brenda një afati të caktuar kohor dhe në këtë mënyrë humb të drejtën që të ndërmarrë atë veprim, gjykatë, pas mocionit të palës do të lejojë atë palë që të ndërmarrë veprimin në fjalë (kthimin në gjendjen e më pashme) nëse vlerësohet se ekzistojnë arsye të justifikueshme për një dështim të tillë. Për më tepër Neni 118 i LPK precizon se mocioni për kthim në gjendjen e mëparshme do të dorëzohet në gjykatë ku veprimi i ometuar do të ishte kryer brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke numëruar nga dita kur arsyet për heqje përfundojnë së ekzistuari, dhe në se pala është njoftuar në lidhje me heqjen vetëm më vonë, duke numëruar ditët nga dita kur pala është njoftuar në lidhje me të.

Përderisa Neni 118 paragrafi 1 i LPK-së në parim parasheh kompetencën e Trupit Gjykses për të trajtuar kërkesat për kthim në gjendje të mëparshme, ato kërkesa që janë parashtruar brenda ankesave kundër aktvendimeve që refuzojnë ankesat / paditë si të parashtruara jashtë afatit, duhet të dëgjohen nga Kolegji i Ankesave si një organ kompetent në trajtimin e ankesave të çfarëdo përmbajtjeje.

Për rastin në fjalë, sipas dokumenteve të parashtruara Ankuesja ka qenë nën trajtim hospitalizomi gjatë periudhës kohore, kur ankesa e saj është dashur të parashtrohet pranë Trupit Gjykses, dhe kështu mund të kishte pasur arsye të justifikueshme për parashtrimin e ankesës së saj pranë Trupit Gjykses pas datës 1 gusht 2009. Ankuesja është liruar nga spitali më 8 tetor 2009 dhe mund të ketë qenë e mundur se ka kuptuar për heqjen e saj pas kësaj date.

Si do që të jetë, Neni 118 paragrafi 3 i LPK-së specifikon se pas skadimit të afatit tre mujor që nga data e heqjes, nuk mund të kërkohet më kthimi në gjendjen e mëparshme. Dita e fundit për ushtrim të ankesës pranë Trupit Gjykses ka qenë 1 gusht 2009 dhe kështu dita e heqjes ka qenë 2 gusht 2009. Periudha kohore prej

tre muajve është llogaritur prej 2 gusht 2009 dhe ka përfunduar më 2 dhjetor 2009. Ankuesja ka ushtruar ankesë pranë Trupit Gjykses pa dhënë ndonjë arsye për ushtrimin e saj me vonesë dhe pa kërkuar në mënyrë eksplicite kthimin në gjendjen e mëparshme. Arsyeja për ushtrim me vonesë të ankesës së saj pranë Trupit Gjykses është dhënë vetëm në ankesën e saj drejtuar Kolegjit të Ankesave më 23 dhjetor 2009. Për këtë arsye, një kërkesë (e veçantë) për kthim në gjendjen e mëparshme do të kishte qenë i pasuksesshëm.

Taksat Gjyqësore

Në pajtim me Rregullat Plotësuese Procedurale të Dhomës së Posaçme në lidhje me taksat gjyqësore që janë të aplikueshme prej datës 10 mars 2010 (bazuar në Nenin 57.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6) procedurat në lëndët që lidhen me Listat e Punëtorëve me të drejta legjitime (Neni 67 i UA të UNMIK-ut 2008/6) si dhe procedurat përkatëse ankimore janë të liruara nga taksat. Prandaj, nuk ka nevojë të merret një vendim në lidhje me taksat gjyqësore.

Richard Winkelhofer, EULEX Gjyqtar Kryesues	nënshkruar
Torsten Koschinka, EULEX Gjyqtar	nënshkruar
Eija-Liisa Helin, EULEX Gjyqtar	nënshkruar
Tobias Lapke, EULEX Regjistruer	nënshkruar